

Partneriteti Publiko-Privat (PPP) në Kosovë



Përgatitur nga: Lëvizja FOL

Të drejtat e autorit ©2026. Lëvizja FOL

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Metodologjia..... | 4 |
| 1. Hyrje..... | 4 |
| 2. Korniza Ligjore për PPP dhe Koncesione..... | 6 |
| Ligji për Partneritetin Publiko-Privat..... | 6 |
| Draft Ligji për PPP..... | 6 |
| Ligji për Prokurimin Publik..... | 7 |
| Aktet nënligjore..... | 7 |
| 3. Korniza Institucionale..... | 8 |
| Ministritë..... | 8 |
| Njësitë PPP..... | 8 |
| Akte të tjerë..... | 9 |
| 4. Sistemet e Të Dhënave për PPP..... | 9 |
| 5. Transparenca dhe të dhënat e hapura..... | 11 |
| 6. Përafrimi me Direktivën e BE-së..... | 12 |
| 7. Sfidat dhe nevoja për reforma..... | 13 |

Metodologjia

Ky raport përmban një analizë të shkurtër së gjendjes me Partneritet Publiko Private në Kosovë, kush janë akterët kryesorë, nevoja për ndryshime ligjore dhe përafrimi me Direktivën e BE-së, transparenca dhe të dhënat e hapura, ndërveprimi me sistemet tjera elektronike në Kosovë.

Ligji për PPP parasheh dy forma të kontraktimit, e ku secila prej tyre zhvillohet ndryshe. Kjo ka determinuar edhe metodologjinë e mbledhjes së të dhënave dhe të analizës së tyre.

Në Kosovë sipas Ligjit për Partneritetin Publiko Privat të miratuar në vitin 2011¹ dallojmë:

PPP në formë të kontratës publike e cila zhvillohet përmes Ligjit për Prokurim Publik dhe platformën e-Prokurimi. Pasi të dhënat nga e-Prokurimi mund të qasen përmes API dhe e cila përmban shumë detaje, ka qenë e mundur që përmes eksportimit në Excel të identifikohen rastet e PPP në formë të kontratës publike. Sistemi i të dhënave për PPP në formë të kontratës publike është analizuar duke identifikuar fushat me të dhëna që vijnë përmes API, të cilat mund të përdoren edhe për digjitalizimin e aplikimeve për koncesione dhe menaxhimin e tyre.

Ndërsa PPP në formë të koncesionit zhvillohet përmes procedurës së dhënë sipas Ligjit për Partneritetin Publiko-Privat. Në këtë formë të PPP partneri privat fiton të drejtën të vjelë tarifa drejtpërdrejt nga përdoruesit e shërbimit apo infrastrukturës. Të dhënat në lidhje me koncesione janë nxjerrë së pari duke vizituar arkivën e faqes PPPKosova.org përmes Archive.org dhe seksionin në uebfaqen e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për koncesionet që janë zhvilluar pas mbylljes së faqes PPPKosova.org.

Ndërsa metodologjia për të identifikuar zbrazëtitrat ligjore dhe përafrimin me Direktivën e BE-së është fokusuar në fushat që preken nga digjitalizimi dhe hapja e të dhënave në lidhje me koncesionet.

1. Hyrje

Partneriteti publiko-privat (PPP) është një model i bashkëpunimit mes institucioneve të sektorit publik dhe kompanitë private për të ofruar një shërbim publik. Zakonisht ky bashkëpunim në shumicën e rasteve ndodh kur institucionet publike kanë mungesë të mjeteve financiare për të kryer një investim të caktuar. Kjo mënyrë e bashkëpunimit u mundëson të dyja palëve të përfitojnë nga burimet dhe përvoja e njëri-tjetrit, duke e bërë këtë model një mjet efikas për të stimuluar rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Bashkëpunimi mes sektorit publik dhe privat në realizimin e investimeve ofron përparësi të shumta si:

- mundësinë për të përfunduar investime të mëdha që nuk mund të financohen tërësisht nga fondet publike,
- shfrytëzimin e përvojës së partnerëve privat për menaxhimin e projekteve investuese,
- shpërndarjen e rrezikut mes palëve.

Përveç kësaj, PPP-të mund të sjellin risi të reja në shërbimet publike dhe të sigurojnë një kontroll më të mirë të kostove dhe afateve të projekteve.

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2784>

Në Kosovë sipas Ligjit për Partneritetin Publiko Privat të miratuar në vitin 2011² dallojmë:

- PPP në formë të kontratës publike e cila zhvillohet përmes Ligjit për Prokurim Publik dhe platformën e-Prokurimi. Këtu pagesa për investimin dhe operimin e infrastrukturës bëhet rregullisht nga Autoriteti Publik bazuar në performancën, cilësinë dhe disponueshmërinë e asaj që është ndërtuar nga partneri privat.
- PPP në formë të koncesionit e cila zhvillohet përmes procedurës së dhënë sipas Ligjit për Partneritetin Publiko-Privat. Në këtë formë të PPP partneri privat fiton të drejtën të vjelë tarifa drejtpërdrejt nga përdoruesit e shërbimit apo infrastrukturës (p.sh., pagesat e biletës së udhëtarëve, tarifafat e një autostrade ose parkimi).

Për shkak të dy mënyrave të ndryshme të zhvillimit të PPP-ve ka dallime të mëdha sa i përket publikimit të të dhënave dhe transparencës. PPP në formë të kontratës publike, pasi përdor e-Prokurimin, atëherë ka nivel të lartë të transparencës dhe të dhënave të strukturuar. Mirëpo PPP në formë të koncesioneve, nuk përdor ndonjë portal elektronik për menaxhimin e të gjithë procesit. Njoftimit për koncesione publikohen në një seksion të uebfaqes së Ministrisë së Financave³, nuk ka të dhëna të strukturuar e ku secili fajll duhet të hapet një e nga një për të mundur analizimin e të dhënave.

Numri i kërkesave të institucioneve publike për të nisur një PPP mund të variojë bazuar në nevojat, kapacitetet dhe prioritetet e tyre specifike. Në Kosovë aktualisht ka vetëm tri marrëveshje aktive për PPP. Janë dhe disa të tjerë që janë në fazën e propozimeve. Komuna e Prishtinës dhe ajo e Gjilanit kanë me numrin më të madh të kërkesave për të nisur një PPP. Deri në fund të vitit 2025 numri i propozim/projekteve të dorëzuara tek Departamenti për PPP nga autoritetet publike për të nisur një partneritet publiko-privat është 23⁴. Të gjitha këto janë kërkesa në trajtim ose kërkesa që pritet të nisin të trajtohen në të ardhmen.

| Autoriteti kontraktues | Emri i projekt-propozimit | Data e dorëzimit të projekt-propozimit | Kohë-zgjatja e kontratës | Lloji i kontratës | Faza |
|------------------------|--|--|--------------------------|-------------------|----------------------|
| Ministria e Financave | ANP "Adem Jashari" | 06/2009 | 20 vite | Koncesion | Në fazën e operimit |
| Komuna e Gjilanit | Rregullimi i infrastrukturës së kompleksit të shkollave të mesme | 22/05/2013 | 15 vite | Koncesion | Në fazën e operimit |
| Komuna e Prishtinës | Projekti i parkingut nëntokësor | 17/01/2017 | 35 vite | Koncesion | Në fazën e operimit |
| Komuna e Prishtinës | Tri shkollat e Prishtinës | 29/11/2019 | 10 vite | Kontratë Publike | Në fazën e ndërtimit |
| Komuna e Podujevës | Parkingu nëntokësor në | 24/03/2022 | 30 vite | Koncesion | Në fazën tenderuese |

Projektet aktuale PPP në Kosovë – Burimit të dhënat e mbledhura nga portali PPP – Ministria e Financave

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2784>

³ <https://mfpt.rks-gov.net/Partneriteti/Ballina/153>

⁴ https://www.institutigap.org/documents/13701_Partneriteti%20Publik-Privat%20_F.pdf

2. Korniza Ligjore për PPP dhe Koncesione

Ligji për Partneritetin Publiko-Privat

Në Kosovë korniza ligjore që rregullon PPP është Ligji për Partneritetin Publiko-Privat i vitit 2011. Ky ligj nuk është në tërësi në përputhje me Direktivën e BE-së për koncesione 2014/23/EU. Megjithatë Kosova ka hartuar një ligj të ri në vitin 2019 por i cili ende nuk është miratuar.

Sipas nenit 6 të ligjit PPP-të mund të zbatohen në dy forma:

- në formë kontraktuese – Forma kontraktuese pastaj ndahet në dy mënyra tjera sipas nenit 7 të ligjit
 - koncesionit
 - kontratës publike

PPP në formë kontraktuese është një marrëveshje që mund të jetë në formë të koncesionit ose kontratës publike ku partneri privat ofron një shërbim ose infrastrukturë publike në emër të autoritetit publik, duke marrë përsipër rrezikun, si dhe përgjegjësitë financiare, teknike, ndërtimore dhe operative.⁵

- në formë institucionale - Ndërsa PPP në formë institucionale mund të themelohet nga një komunë përmes blerjes së aksioneve të komunës nga një ose më shumë partnerë privat në një ndërmarrje publike ekzistuese funksioni i vetëm i së cilës është kryerja e një shërbimi publik ose ofrimi i një infrastrukture publike, me kusht që partneri privat po ashtu merr pjesë në drejtimin e ndërmarrjes publike ose merr pjesë në kryerjen e shërbimit publik apo ofrimin e infrastrukturës publike. Nëse themelimi i një partneriteti publiko privat institucional kërkon shitjen e aksioneve në një ndërmarrje publike e cila është në pronësi të Republikës së Kosovës, atëherë themelimi i këtij PPP institucional i nënshtrohet miratimit të Qeverisë dhe të Kuvendit të Kosovës në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike⁶. Më saktë, Autoriteti Publik dhe Partneri Privat formojnë së bashku një subjekt të ri juridik (pra një konzorcium/ortakëri). Shteti dhe privati bëhen aksionarë në këtë kompani të re, duke ndarë bashkërisht rreziqet, investimet, vendimmarrjen dhe fitimet. Kjo strukturë zakonisht përdoret në sektorë strategjikë ku shteti dëshiron të mbajë një prani dhe kontroll aktiv institucional mbi projektin.

Draft Ligji për PPP

Qeveria e Kosovës në programin legjislativ për vitin 2024 ka paraparë që të miratohet projektligj të ri për PPP-të, mirëpo kjo nuk ka ndodhur. Ky projektligj është i përfunduar dhe ka kaluar fazën e konsultimit publik që nga viti 2019, por ende nuk është dorëzuar në Kuvendin e Kosovës për procedurat e shqyrtimit dhe miratimit. Projektligji është përpiluar për të adresuar ndryshimet e nevojshme në ligjin aktual për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së, siç përcaktohet edhe nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA). Më konkretisht, ky projektligj bën transpozimin e Direktivës së re të BE-së për koncesione dhe përmes tij synohet që të bëhet eliminimi i burokracisë dhe lehtësimi i procedurave për autoritetet kontraktuese, si dhe harmonizimi me Programin e Investimeve Publike (PIP)⁷.

⁵ https://www.institutigap.org/documents/13701_Partneriteti%20Publik-Privat%20_F.pdf

⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2784>

⁷ [Dokument konsultimi për Projektligjin për Partneritet Publiko-Privat final.docx](#)

Ligji aktual ka ngjashmëri me LPP sa i përket afateve procedurale. Për shembull kërkesa për kualifikim të ofertave është 20 ditë kalendarike, e njëjtë si në procedurën e kufizuar të prokurimit publik, ku afati për dorëzimin e kërkesës për parakualifikim është 20 ditë. Në nenin 27 të Ligjit për PPP thuhet që kriteret bëhen sipas LPP, ndërsa nuk ka kuptim që një nen më lartë, neni 26, që flet për ftesën për parakualifikim, të bëhet sipas Ligjit për PPP.

Ndërsa Procedurat një-fazëshe dhe dy-fazëshe mbi kërkesën për propozime, janë pothuajse identike me procedurën e kufizuar dhe atë konkurruese me negociata sipas Ligjit për Prokurimin Publik.

Te neni 32, Sigurimi i Tenderit, nuk përcaktohet vlerë e sigurimit, për dallim të LPP e cila specifikon që sigurimi duhet të jetë 1-3% e vlerës së parashikuar të tenderit. Ndërsa për dorëzim të propozimeve sipas neni 34, njëjtë si të LPP afati është minimum 40 ditë.

Ligji ka mangësi të mëdha sa i përket publikimit të dokumenteve të ndryshme, të cilën përgjegjësi sipas neni 43 e ka Departamenti i PPP. Për më tepër dokumentet publikohen në faqen e këtij departamenti e jo në ndonjë faqe të krijuar enkas për këtë qëllim.

Kur një çështje e natyrës procedurale që ndërlidhet me dhënien e një Partneriteti Publiko Privat nuk është e rregulluar me këtë ligj atëherë zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurim Publik. Nëse për zbatimin e dispozitave përkatëse të Ligjit për Prokurim Publik kërkohet ndonjë aprovim ose vendim i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik ose Agjencisë Qendrore të Prokurimit, autoriteti për dhënien e këtij miratimi ushtrohet nga KPPP.

Ligji për Prokurimin Publik

Ligji për Prokurimin Publik është miratuar në vitin 2011 dhe është amendamentuar edhe tri herë të tjera, së fundit në vitin 2016⁸. Sipas Ligjit për PPP, dhënia e PPP përmes kontratës publike bëhet përmes Ligjit për Prokurim Publik. Neni 7.3 i Ligjit për PPP më saktë thotë:

Dhënia e Partneritetit Publiko Privat në formë të Kontratës Publike siç është përcaktuar në nënparagrafin 1.2 të paragrafit 1. të këtij neni bëhet në pajtim me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Në lidhje me të gjitha çështjet tjera, Kontrata Publike e përcaktuar në nënparagrafin 1.2 të paragrafit 1. të këtij neni rregullohet në bazë të këtij ligji.

Pra, procedura zhvillohet përmes Ligjit të Prokurimit Publik, e gjithashtu edhe faza e ankimit bëhet përmes këtij ligji, ku palët e pakënaqura mund të ankohen në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Prej disa vitesh, Kosova ka nisur procesin për hartimin dhe miratimin e një ligji të ri për prokurimin publik. Ligji i ri është i domosdoshëm për t'u përafuar plotësisht me *acquis* të BE-së në këtë fushë.

Megjithatë, përpjekjet janë karakterizuar nga vonesa të theksuara zbatimi. Ndonëse Projektligji i ri ka qenë pjesë e programit legjislativ të Qeverisë së Kosovës në vazhdimësi (përfshirë planet e viteve 2022, 2023, 2024 dhe 2025), ai ka ngecur në proceset e miratimit përfundimtar.

Akte nënligjore

Akte nënligjore të Ligjit për PPP nuk ka të miratuara, mirëpo për pjesën e PPP që zhvillohet me Ligjin e Prokurimit Publik janë disa akte nënligjore, e më kryesori është Rregullat për Prokurimin Publik i cili

⁸ <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Ligjet/shq/LPP%20i%20konsoliduar.pdf>

përcakton detaje se si përshtatshmërisht të zhvillohen procedura e PPP duke përdorur dokumentet standarde të miratuara⁹.

3. Korniza Institucionale

Ministritë

Ministria e Financave ka peshën më të madhe institucionale në menaxhimin e PPP-ve, pasi funksionon si filtri kryesor financiar dhe rregullator, pasi udhëheq Komitetin e PPP i cili është organi kryesor që miraton ose refuzon PPP. Pastaj bën vlerësim të rrezikut fiskal, pasi asnjë projekt PPP nuk mund të aprovohet pa u vlerësuar ndikimi në buxhet. Ndërsa brenda kësaj ministrie funksionon Departamenti Qendror i PPP, roli i të cilit është shpjeguar më lartë.

Ministritë tjera relevante janë ato të cilat e kanë nga një anëtarë të përhershëm në KPPP dhe të cilit kanë të drejtë vote.

Njësitë PPP

Ligji për PPP është mjaft burokratik ku menaxhimi dhe mbikëqyrja e projekteve të Partneritetit Publiko-Privat bëhet përmes një strukture të qartë dhe ku përgjegjësitë ndahen në mes tri organeve të ndryshme:

- **Komiteti për Partneritet Publiko-Privat (KPPP):** Ky është organi vendimmarrës në nivel qeveritar. Ai përbëhet nga pesë anëtarë: Ministri i Financave (që është kryesuesi i përhershëm) dhe katër ministra të tjerë (ose zëvendëskryeministra) të emëruar nga Qeveria. Detyra e tij është të miratojë ose refuzojë projektet e propozuara për PPP, të aprovojë dokumentacionin e tenderit dhe të vlerësojë ndikimin financiar dhe ekonomik të çdo projekti. KPPP ka për detyrë të mbajë Regjistrin Kombëtar të PPP sipas nenit 17 të LPPP¹⁰. KPPP merr vendime për të miratuar ose refuzuar një projekt si të përshtatshëm për PPP me shumicë votash. Ministri i Financave ka të drejtë vetoje.
- **Departamenti Qendror për Partneritet Publiko-Privat (DQ PPP):** Ky departament operon brenda Ministrisë së Financave dhe shërben si sekretariat teknik për KPPP-në. Ekspertët e këtij departamenti ofrojnë mbështetje profesionale, këshillojnë institucionet, rishikojnë propozimet para se të shkojnë për votim në Komitet, si dhe mbikëqyrin dhe monitorojnë zbatimin e kontratave të nënshkruara ndër vite.
- **Autoriteti Kontraktues:** Ky është institucioni publik (mund të jetë një ministri, një komunë, apo një ndërmarrje publike) që e inicion dhe e ka në pronësi projektin. Autoriteti Kontraktues harton studimet e fizibilitetit, menaxhon direkt procedurat e prokurimit/tenderimit dhe është menaxheri i drejtpërdrejtë i kontratës me partnerin privat pas nënshkrimit.

⁹ <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/versioni%20i%20konsoliduar%20i%20Rregullores%20Nr.%20001%202022%20i%20plot%C3%ABsuar%20dhe%20ndryshuar%20me%20Rregulloren%20Nr.%20002%202024.pdf>

¹⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2784>

Akterët tjerë

OSHP – Organi Shqyrtues i Prokurimit është organi që shqyrton ankesat e operatorëve ekonomik në pretendimet për shkelje të Ligjit për Prokurim Publik. Pasi koncesionet në formë të kontratës publike shfrytëzojnë Ligjin për Prokurim Publik, atëherë edhe ankesat eventuale do të dorëzohen në OSHP në përputhje me LPP dhe me nenin 46 të Ligjit për PPP.

4. Sistemet e Të Dhënave për PPP

Për zhvillimin e procedurave për PPP-të në formë të kontratës publike (sipas nenit 7.3 të LPPP) përdoret Ligji për Prokurim Publik dhe rrjedhimisht edhe portali e-Prokurimi. Në këtë rast të dhënat janë më të hapura pasi ato mund të qasen përmes API (Application Programming Interface)¹¹ të publikuar nga KRPP, e ku API është i ndërtuar në bazë të kritereve Open Contracting Data Standard (OCDS)¹².

API është një grup rregullash dhe mekanizmash që lejon dy programe ose sisteme të ndryshme kompjuterike të komunikojnë dhe të shkëmbejnë të dhëna me njëri-tjetrin, pa pasur nevojë të dinë se si funksionon secili nga brenda.

Të dhënat që janë të përputhura janë në lidhje me përshkrimin e projektit, procesin e prokurimit dhe detajet e kontratës, dhe një pjesë e të dhënave financiare. Ndërsa të dhënat për implementimin e projektit nuk janë pjesë e e-Prokurimit dhe rrjedhimisht as nuk mund të qasen përmes API.

Sipas API në bazë të formatit OCDS këto janë disa nga të dhënat e strukturuar që çdo palë e interesuar mund ti qaset:

| Kodi | Emri | Përshkrimi |
|---------------------------------|---------------------------------|--|
| supplier | Furnizuesi | Emri i kompanisë që ka fituar kontratën |
| Tenderer | Tenderuesit | Emrat e të gjithë kompanive që kanë ofertuar |
| ProcuringEntity | Autoriteti Kontraktues | Emri i Autoritetit Kontraktues që ka publikuar tenderin |
| tenderName | Emri i tenderit | Titulli i aktivitetit të prokurimit |
| uid | Numri identifikues | Një numër identifikues i brendshëm që i caktohet çdo tenderi |
| ProcurementMethod | Mënyra e prokurimit | |
| ProcurementMethodDetails | Detajet e mënyrës së prokurimit | |
| AwardCriteria | Kriteri i dhënies | Çmimi më i ulët ose ai ekonomikisht më i favorshëm |
| Value | Vlera | Vlera e parashikuar e tenderit |
| Lots | Lotet | Numri i loteve dhe ndarja e tyre |
| Value (Award) | Vlera e kontratës | |
| awardStatus | Statusi i dhënies së kontratës | |
| contractPeriod | Periudha e kontratës | Data e fillimit dhe mbarimit |

¹¹ [ASP.NET Web API Help Page](#)

¹² [Primer — Open Contracting Data Standard 1.1.5 documentation](#)

API përfshin disa kategori në këto linqe:

<https://ocdskrpp.rks-gov.net/KRPPAPI/Parties>

<https://ocdskrpp.rks-gov.net/KRPPAPI/Award>

<https://ocdskrpp.rks-gov.net/KRPPAPI/Bids>

<https://ocdskrpp.rks-gov.net/KRPPAPI/Tender>

<https://ocdskrpp.rks-gov.net/KRPPAPI/Partyrole>

<https://ocdskrpp.rks-gov.net/KRPPAPI/Document>

Linku i parë përfshin të gjitha të dhënat në lidhje me operatorët ekonomik të regjistruar në platformë

Linku i dytë përfshin të dhëna në lidhje me fituesin e kontratës, si psh. Emri i operatorit ekonomik, çmimi i kontratës, data e dhënies së kontratës, etj.

Linku i tretë përfshin të dhënat në lidhje me të gjithë ofertuesit për një tender të caktuar si psh, emri i tenderit, emri i ofertuesit, çmimi i secilit ofertues, data e dorëzimit të ofertës, etj.

Linku i katërt përfshin të dhënat për tenderin, siç është titulli i tenderit, kodi unik, numri i prokurimit, ndarja në lote, vlera e parashikuar, data e publikimit, etj.

Linku i pestë përfshin të dhëna në lidhje me rolet e aktoreve që janë të regjistruar në platformë dhe kthen këto të dhëna:

- Furnizuesi
- Blerësi
- Donatori
- Ofertuesi
- Autoriteti Kontraktues

Ndërsa linku i gjashtë tregon llojet e dokumenteve që mund të qasen përmes API, linku i tyre, data e publikimit dhe numri i prokurimit.

Këto janë vetëm disa nga të dhënat në sistem që mund të qasën në formë të strukturuar dhe të eksportohen përmes Microsoft Excel në formatin CSV për analizë të mëtutjeshme ose mund të ndërtohen platforma tjera që promovojnë transparencën.

Ndërsa, në rastet e koncesioneve, nuk ka të dhëna të strukturuar pasi publikimit e dokumenteve për një kohë janë bërë në portalin PPPKosova.org, i cili nuk është më aktiv. Ndërsa tani njoftimet publikohen në uebfaqen e Ministrisë së Financave¹³. Këto dokumente janë në formatin Excel ose PDF, ndërsa nuk ka datase të strukturuar që mund të përdoren nga palët e interesuara. Mbledhja e informacioneve dhe strukturimi i tyre duhet të bëhet nga personi i interesuar manualisht duke shkarkuar të gjitha dokumentet një nga një. Pra nuk ka interoperabilitet me platformën e-Prokurimi. Përderisa Ligji për PPP nuk e parasheh që koncesionet të zhvillohen përmes eProkurimit, në mungesë të një ligji të ri që do ta ndryshonte këtë qasje, nuk ka mundësi që tani për tani të ekzistojnë të dhëna të strukturuar. Për shkak që në Kosovë nuk ka shumë koncesione, edhe nuk i është fokus më i madh

¹³ [Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - MFPT](#)

ndërtimi të një platformë ku do të mund të aplikohet për projekte dhe të bëhet menaxhimi i të gjithë ciklit të projekteve PPP.

Ligji për PPP e obligon KPPP të mbajë Regjistrin Kombëtar të PPP, mirëpo nuk ka të dhëna se as është ky regjistër i qasshëm online, apo është ndonjë dokument i thjeshtë. Sidoqoftë nuk ka të dhëna digjitale, të strukturuar ku mund të shihen më një faqe të gjitha projektet PPP si ato aktive, si ato që janë në fazën e propozimeve.

Prandaj është shumë e rëndësishme që të ketë të dhëna të strukturuar, mundësisht në formatin e OCDS, e ku do të mund të mblidheshin të dhëna edhe PPP.

Megjithatë edhe pse shumica e të dhënave janë të hapura, edhe të PPP në formë të kontratës publike, nuk ka të dhëna të strukturuar sa i përket menaxhimit të kontratës dhe pagesave. Pra të dhënat si, pagesat, data e pagesave, fillimi i kontratës, përfundimi i kontratës nuk mund të qasen përmes API. Vitin e kaluar sistemi i e-Prokurimit është ndërlidhur me platformën e Sistemit të Menaxhimit të Financave Publike¹⁴, kështu që ka shpresa se në të ardhmen edhe të dhënat financiare do të bëhen të qasshme përmes API.

5. Transparenca dhe të dhënat e hapura

Siç është përmendur më lartë, nëse procedura për PPP zhvillohet përmes eProkurimit atëherë i nënshtrohet rregullave të transparencës që ofron eProkurimi si për kontratat e zakonshme të prokurimit publik. Operatorët ekonomikë (qofshin ata vendorë apo konsorciume ndërkombëtare) lejohen të shkarkojnë dosjen e tenderit, të bëjnë pyetje dhe të dorëzojnë ofertat e tyre në mënyrë elektronike. Palët tjera të interesuara mund të shkarkojnë kontratën dhe të dhëna tjera pas regjistrimit si person fizik.

Ndërsa një pjesë e madhe e të dhënave gjithashtu mund të qasen për KRPP API, e përmendur gjerësisht në kapitullin paraprak.

Si shkak i të dhënave të hapura në platformën e-Prokurimi, janë krijuar disa platforma tjera që mundësojnë analizimin e të dhënave, siç janë prokurimihapur.org apo redflags.dplus.org. Gjithashtu ka edhe disa platforma të tjera komerciale që ndihmojnë bizneset e interesuara në përcjelljen e publikimive të prokurimeve përmes njoftimeve automatike në email.

Mirëpo në rast të koncesioneve sipas Ligjit për PPP atëherë transparenca ka mangësi dhe ka nevojë të madhe për digjitalizim. Për një kohë të gjatë Uebfaqja e PPP Kosova nuk është funksionale. Në të kaluarën në atë uebfaqe janë publikuar të gjitha njoftimet për PPP. Tani kjo faqe është brenda uebfaqes së Ministrisë së Financave dhe ku të gjitha të dhënat nuk janë të filtruara sipas projekteve (ashtu si funksionon e-Prokurimi), por janë të grumbulluar sipas llojit të dokumentit, psh të gjitha njoftimit për dhënie të kontratës në një vend, e jo të gjitha njoftimit që kanë të bëjnë me një projekt në një vend. Për shkak të mbylljes së faqes PPPKosova.org tani të gjitha njoftimet e bartura në faqen e Ministrisë kanë datë të njëjtë të publikimit. Ndërsa sa i përket të dhënave të hapura, ato nuk mund të qasen ndryshe përveç mbledhjes manuale të tyre përmes shkarkimit të dokumenteve të publikuara.

Kontratat e PPP-ve mund të zgjasin disa vite. Një sistem i integruar digjital lejon krijimin e një gjurme të qartë auditimi në rast dyshimesh apo nëse lind nevoja për ndryshime, ku të gjitha ato ndryshime. Pra sa i përket koncesioneve ka nevojë të theksuar për digjitalizim të procesit dhe interoperabilitet

¹⁴ <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=683>

me sisteme tjera siç është eProkurimi, Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, etj.

6. Përafrimi me Direktivën e BE-së

Direktiva e BE që rregullon dhënien e koncesioneve është 2014/23/EU e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2014.

Raporti Vjetor 2025 për Kosovën i përgatitur nga Bashkimi Evropian thekson se Kosova është ndërmjet njëfarë niveli të përgatitjes dhe një niveli mesatar të përgatitjes dhe ka bërë përparim të kufizuar në këtë fushë. Kosova ka përparuar me përdorimin e kriterit të raportit më të mirë çmim-cilësi, uli përdorimin e procedurave të negociuara pa publikim paraprak të një njoftimi kontrate dhe filloi të ndërlihdë platformën e saj të prokurimit elektronik me sisteme të tjera qeveritare të IT-së¹⁵. Ndërsa sa i përket PPP, BE thekson në veçanti se Kosova duhet të:

të miratojë një ligj të ri për prokurimin publik dhe një ligj të ri për partneritetet/koncesionet publiko-private në përputhje me acquis-in e BE-së dhe angazhimet e Agjendës së Reformës; të zhvillojë legjislacionin përkatës zbatues dhe të sigurojë zbatimin e tij të duhur;

Pra kërkesa e BE është që të miratohet ligj për koncesione që është në përputhje me Direktivën e BE. Draft ligji për PPP është përgatitur që në vitin 2019, e futur në agjendën legjislativë në vitin 2021¹⁶, 2022¹⁷, 2024¹⁸, , mirëpo ende nuk është miratuar. Duhet theksuar se kërkesa nga BE për miratim të një ligji të ri dhe përafrim Direktivën e BE-së për koncesione 2014/23/EU, është që nga viti 2016¹⁹. Pra për një dekadë, Kosova nuk ka arritur që të miratojë një ligj të ri për PPP.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në vitin 2016 dhe hyrjes së saj në fuqi, njëri nga veprimet që Kosova duhet të ndërmarrë është **përafrimi ligjor me legjislacionin e BE-së**, i cili veprim i ka sfidat e veta pasi që MSA përcakton se Kosova duhet të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj në fuqi dhe legjislacioni i ardhshëm do të jenë gjithnjë në përputhje me legjislacionin e BE-së apo siç njihet *acquis* dhe se zbatimi i saj duhet të bëhet në mënyrën e duhur²⁰.

Pasi Ligji për PPP është miratuar para se MSA të hyjë në fuqi, është shtuar nevoja për një ligj të ri i cili do të ishte në përputhje me Direktivën e BE-së.

Në anën tjetër, nevoja që të ndryshohet Ligji për Partneritet Publiko Privat ka të bëjë edhe me zvogëlimin e burokracisë aktuale në mënyrë që të arrihet një efikasitet më i madh në implementimin e projekteve PPP. Këto procedura janë mjaft të gjata dhe kërkojnë kohë për t'u përgatitur nga autoritetet publike dhe për t'u implementuar. Për këtë arsye, synohet që, me qëllim të lehtësimit të procedurave për autoritetet kontraktuese që të lejohet mundësia për projekte me vlerë të caktuar.

¹⁵ https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/2025/documents/Kosovo%202025%20Report_SQ.DOCX

¹⁶ [Programi-Legjislativ-per-Vitin-2021_27.10.2021.pdf](#)

¹⁷ [Programi-Legjislativ-per-vitin-2022.-27.10.2022.pdf](#)

¹⁸ [Programi-Legjislativ-per-vitin-2024-15-korrik-1.pdf](#)

¹⁹ [20161109 kosovo report 2016 alb.pdf](#)

²⁰ [Dokument konsultimi për Projektligjin për Partneritet Publiko-Privat final.docx](#)

Në anën tjetër një raporti i OECD/SIGMA thotë se “Ligji për PPP ofron një kornizë të fuqishme ligjore në këtë fushë. Megjithatë, Ligji lë hapësirë për përafrimin e mëtejshëm me acquis të BE-së, në mënyrë që të transpozohet Direktiva e re për koncesione”²¹.

Dallime në mes të Direktivës së BE dhe LPPP në Kosovë janë të shumta por mund të përmbliken në disa pika kryesore:

- Përjashtimet në lidhje me se në cilat fusha mund të aplikohen koncesionet dallojnë në mes Direktivës dhe LPPP, psh sipas Direktivës²², koncesione nuk mund të jepen për sektorin e ujit, si psh prodhimi i ujit të pijshëm, trajtimi i ujërave të zeza, ndërsa LPPP e lejon shprehimisht koncesionimin e tyre²³.
- Kohëzgjatja e koncesioneve është një pikë tjetër dallimi. LPPP nuk përcakton ndonjë kufizim kohor për kohëzgjatjen e koncesioneve, mirëpo me miratimin e KPPP, një autoritet kontraktues mund të vazhdojë kohëzgjatjen e marrëveshjes për një periudhë shtesë e cila nuk tejkalon më shumë se ¼ (një të katërtën) e kohëzgjatjes fillestare të përcaktuar në marrëveshje. Pra rol kyq ka KPPP e cilat miraton zgjatjen për ¼ e kohës fillestare, ndërsa Direktiva nuk specifikon kohëzgjatjen e as për sa kohë mund të zgjatet kontrata fillestare. Ndërsa sipas Direktivës nuk ka mekanizëm aprovues, që do të aprovonte kohën shtesë.
- Kuadri institucional - Direktiva e BE-së: Nuk imponon një strukturë specifike, por kërkon që proceset të menaxhohen nga Autoriteti Kontraktues.
- Ligji i Kosovës për PPP është shumë i centralizuar. Roli i Komitetit të PPP-ve (Neni 8) dhe Departamentit Qendror për PPP në Ministrinë e Financave është dominues. Çdo projekt, sado i vogël (mbi pragje të caktuara), duhet të kalojë përmes KPPP e cila është një barrë administrative pasi ky Komitet jo gjithmonë është funksional, pasi Komiteti është me anëtarë politik (ministra ose zëvendës ministra).

7. Sfidat dhe nevoja për reforma

PPP janë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik, për shkak të potencialit të tyre për të sjellë investime të mëdha, të cilat përmirësojnë jetën e qytetarëve. Edhe pse në Kosovë për momentin ka pak PPP që janë në proces, Kosova duhet ngrisë nivelin e transparencës përmes të dhënave të hapura, mirëpo së pari nevojiten ndryshime ligjore për të përafruar Ligjin për PPP me Direktivën e BE-së.

Zbatimi i PPP në Kosovë ka disa sfida dhe nevoja për reforma, të cilat janë të listuara më poshtë:

- Aprovimi i Ligjit të ri për PPP, i cili do të ishte më pak burokratik dhe përafrimi me Direktivën e BE-së
- Rritja e transparencës për projektet e PPP, ku do të mundësohej që të gjitha format e PPP të aplikohesh në një portal qendror. Në këtë mënyrë do rritej transparenca përmes të dhënave të hapura. Transparenca më e madhe do të mundësonte parandalimin e shkeljeve ligjore.

²¹ [Baseline Measurement Report, Kosovo \(EN\)](#)

²² Neni 12. [Directive 2014/23/EU of the European Parliament and of the Council of 26 February 2014 on the award of concession contractsText ãith EEA relevance](#)

²³ Neni 2 i LPPP. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2784>

FOL